

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6249  
E enjte, 25 shkurt 2021  
çmimi 0.40 €

## Mosgjedhja e presidentit prodhon krizën më të thellë kushtetuese



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

GJYKATA SPECIALE KA MBAJTUR KONFERENCËN E DYTË STATUSORE  
PËR KRERËT E OVLUÇK-së

## MBROJTJA E GUCATIT DHE AJO E HARADINAJT KËRKOJNË KOHË PËR SHQYRTIMIN E DOSJEVE



**A**vokatët e Hysni Gucati dhe ata të Nasim Haradinajt kanë kërkuar kohë që të përgatiten për gjyqin ndaj krerëve të OVLUÇK-së. Në konferencën e

dytë statusore të Dhomave të Specializuara në Hagë, ata kanë bërë me dije se, përveç mijëra faqeve me materiale, janë edhe qindra orë videoincizime të cilat ende

nuk i kanë shqyrtuar. Mbrojtja ka treguar se ka nisur t'i kryejë hetimet që të përgatiten për procesin gjyqësor, duke shtuar se do të dorëzojë edhe një dosje paraprake

### OPINION

**KADARE, NJË SHKRIMTAR  
QË BËN ÇMOS PËR  
TA MBROJTUR KOSOVËN  
DHE ÇËSHTJEN E SAJ** F. 11

Bedri  
ISLAMI



### AKTUALE



**TRE TË VDEKUR DHE 461 RASTE  
TË REJA ME COVID NË 24 ORËT E  
FUNDIT** F. 3

**QEVERIA MIRATON PROGRAMIN  
PËR KOMUNITETET** F. 7

**LANSOHET MANUALI  
PËR AKREDITIM PËR EKSPERTË  
NDËRKOMBËTARË** F. 7

### EKONOMI

**HYKMETE BAJRAMI  
JEP DORËHEQJE NGA DETYRA  
E MINISTRES SË FINANCAVE** F. 8

**CERTIFIKOHEN 53 AUDITORË TË  
ENERGJISË** F. 8

**MIRATOHEN APLIKACIONET PËR  
GRANTE INVESTUESE** F. 9

## PARLAMENTI EVROPIAN: PAVARËSIA E KOSOVËS, E PAKTHYESHME

Eurodeputetët edhe një herë kanë konstatuar se pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme. Në raportin e miratuar për Kosovën të Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian, ata u kanë bërë thirrje pesë shteteve të BE-së të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, që ta bëjnë një gjë të tillë. Sipas tyre, njohja nga të gjitha



shtetet e BE-së do të ishte në dobi të normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë

## 12 TË ARRESTUAR, 400 MIJË EURO TË SEKUESTRUARA, ME DYSHIMET PËR RYSHFET NË SUBVENCIONET NË BUJQËSI



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Bideni mban takimin e parë të huaj me kryeministrin e Kanadasë

UASHINGTON, 24 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka biseduar me kryeministrin e Kanadasë, Justin Trudeau. Ishte ky takimi i parë dypalësh me një udhëheqës të huaj prejse ka marrë detyrën më 20 janar. "Shtetet e Bashkuara nuk kanë asnjë mik më të afërt se Kanadanë", ka deklaruar Biden. Presidentët e ShBA-së tradicionalisht ftojnë kryeministrin kanadez për takimin e tyre të parë me një udhëheqës botëror. Në kohët para-pandemike, kjo do të përfshinte një bisedë në Zyrën Ovale, një konferencë të përbashkët për shtyp dhe, ndoshta, një drekë. Por, kufizimet nga koronavirusi i detyruan dy udhëheqësit të takohen virtualisht.

Të dy ata vunë në dukje prioritet e përbashkëta të politikës që sillen rreth ndryshimit të klimës dhe Kinës. Një çështje madhore për dy udhëheqësit është ndalimi i dy kanadezëve në Kinë, nën akuzat për spiunim. Ata mbahen në burg që nga viti 2018. Kanadaja pretendon se Michael Spavor dhe Michael Kovrig janë arrestuar në shenjë hakmarrjeje për arrestimin e kreut të kompanisë kineze Huawei, Meng Wanzhou, me urdhër të ShBA-së. "Do të punojmë së bashku derisa ta sigurojmë kthimin e tyre të sigurt", ka thënë Bideni. Biden dhe Trudeau nuk u morën pyetje nga gazetarët, gjë që është e pazakonshme në Uashington për një ngjarje bilaterale si kjo.



## Thomas-Greenfield konfirmohet ambasadore e ShBA-së në OKB



UASHINGTON, 24 SHKURT - Senati i Shteteve të Bashkuara ka konfirmuar emërimin e diplomates veterane Linda Thomas-Greenfield si ambasadore e ShBA-së në Kombet e Bashkuara. Votimi me 78 vota për dhe 20 kundër reflektoi mbështetjen edhe të Partisë Demokratike, edhe të asaj Republikane për të. "Ajo do ta marrë rolin e ambasadores në Kombet e Bashkuara në një kohë kur kombet e botës duhet ta

thellojnë bashkëpunimin e tyre në luftën kundër [sëmundjes] Covid-19 dhe në luftën kundër ndryshimit të klimës", ka theksuar udhëheqësi i shumicës në Senat, Chuck Shumer. Thomas-Greenfield ka kaluar dekada në shërbimin e jashtëm, duke përfshirë pozita të ndryshme në Liberi, Zvicër dhe Pakistan. Ajo, po ashtu, ka kaluar disa vjet si diplomate e lartë e Shteteve të Bashkuara për Afrikën dhe ka mbajtur një

post të lartë në Zyrën e Popullsisë, Refugjatëve dhe Migracionit të Departamentit të Shtetit. Thomas-Greenfield pritet të fillojë punën përpara se Shtetet e Bashkuara të marrin presidencën e radhës të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në muajin mars. Konfirmimi i Thomas-Greenfieldit shihet si përmbyllje e një zotimi të presidentit të ri amerikan, Joe Biden, për të zgjedhur një kabinet më të larmishëm.

## Kryeqyteti britanik ka tani më shumë miliardë

LONDRË, 24 SHKURT - Londra ia ka kaluar Nju-Jorkut sa i takon përqendrimit të lartë të miliardërëve të botës, sipas një raporti që tregon se sa para kanë bërë më të pasurit e botës gjatë pandemisë së koronavirusit. Rreth 875 mijë londinezë janë miliardë, sipas një studimi të kryer nga një kompani konsulence, Knight Frank. Kjo do të thotë se një në dhjetë persona që jetojnë në Londër janë miliardë dhe të dhënat nxjerrin në pah edhe hendekun e madh të pabarazisë në kryeqytetin britanik. Më shumë se 2.5 milionë banorë të Londrës klasifikohet se jetojnë në varfëri sipas shifrave zyrtare. Raporti tregon

se rreth 875 mijë banorë të Londrës kanë asete, përfshirë prona, me vlerë më të madhe se 1 miliardë dollarë, çka i bën ata të quhen individë me një pasuri të madhe neto. Ndërsa në Nju Jork, sipas vlerësimeve, jetojnë 820 mijë miliardë, çka e rendit qytetin në vendin e dytë. Sa i takon Londrës, kostoja e lartë e strehimit atje ka bërë që shumë njerëz të ngjiten në kategorinë e miliardërëve. Pandemia ka bërë që të pasurit të shtojnë pasuritë e tyre por ndërkohë, ata janë edhe të shqetësuar se pabarazia në rritje mund të bëjë që qeveritë të vendosin taksa mbi pasuritë, e kjo është edhe frika më e madhe e tyre pas koronavirusit.



Gjykata Speciale ka mbajtur konferencën e dytë statusore për krerët e OVLUÇK-së

## Mbrojtja e Gucatit dhe ajo e Haradinajt kërkojnë kohë për shqyrtimin e dosjeve

Avokatët e Hysni Gucatit dhe të Nasim Haradinajt kanë kërkuar kohë që të përgatiten për gjyqin ndaj krerëve të OVLUÇK-së. Në konferencën e dytë statusore të Dhomave të Specializuara në Hagë, ata kanë bërë me dije se, përveç mijëra faqeve me materiale, janë edhe qindra orë videoincizime të cilat ende nuk i kanë shqyrtuar. Mbrojtja ka treguar se ka nisur t'i kryejë hetimet që të përgatitet për procesin gjyqësor, duke shtuar se do të dorëzojë edhe një dosje paraprake



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 SHKURT - Mbrojtja e krerëve e Organizatës e Veteranëve të Luftës të UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt, ka kërkuar që gjyqi ndaj tyre të mos nisë para 30 gushtit. Në konferencën e dytë statusore të Dhomave të Specializuara në Hagë, avokatët e Gucatit dhe Haradinajt kanë deklaruar se u duhet kohë për t'i shqyrtuar materialet.

Gjatë seancës të së mërkurës, mbrojtja ka bërë me dije ka nisur hetimet për çështjen dhe që nga 4 janari ka pranuar mbi 3 000 faqe materiale. Avokati i Gucatit, Jonathan Rees, ka deklaruar se përveç 3 000 faqeve me materiale janë edhe 100 orë videoincizime të cilat ende nuk i kanë shqyrtuar. Sipas tij, mbrojtja ka nisur t'i kryejë hetimet që të përgatitet për procesin gjyqësor, duke shtuar se do të dorëzojë edhe një dosje paraprake.

Rees ka kërkuar 20 korrikun si datë për depozitimin e dosjeve. "ZPS-ja përgjigjet se s'na duhet kohë për të bërë hetime. ZPS-ja ka kërkuar shtatë muaj nga data e arrestimeve për ta dorëzuar dosjen para gjyqësorit. Ne kërkojmë rreth tre muaj. E kemi bërë të qartë se e kemi ndërmend ta hetojmë çështjen që lidhet me konfidencialitetin, sikurse pretendohet nga prokuroria. E kemi bërë të qartë se e kemi ndërmend ta hetojmë çështjen e rrethanave se si ato paketa erdhën në selinë e OVLUÇK-së. ZPS-ja s'ka paraqitur prova në këtë kontest, por ne dëshirojmë të hetojmë këtë aspekt", ka thënë Reis, duke treguar se u duhet ende kohë. "Kemi ndërmend të flasim me dëshmitarë që kanë qenë të pranishëm. Aktakuza nuk kufizohet vetëm tek ato konferenca shtypi, por duke përfshirë një periudhë gjashtëmuajshe kur kanë ndodhur ngjarjet që pretendohet", është shprehur ai.

Edhe avokati i Haradinajt, Toby Cadman, ka kërkuar kohë. Sipas tij, situata me pandeminë po ua vështirëson që t'i kryejnë hetimet, pasi kanë edhe vështirësi që të udhëtojnë drejt Kosovës për të intervistuar dëshmitarë. "Nga këto 379 materiale që na janë dorëzuar që përmend prokuroria, thuhet se 122 tashmë na janë dorëzuar. Ne duhet ta kontrollojmë këtë punë. Do të na ndihmonte nëse do të na informonte nëse ka ndonjë paketë veçmas që do të na dorëzohet. Sa iu përket incizimeve, transkriptimeve e përkthimeve, duhet të verifikojmë nëse përkthimet e transkriptive janë të sakta. Ne nuk mund të mbështetemi vetëm në fjalën e prokurorisë. Çdo gjuhë ka veçoritë dhe dialektet e veta dhe ne nuk mund të pranojmë që ajo

që thuhet në transkriptë është ajo që thuhet nga folësi", ka deklaruar ai.

Megjithatë, prokuroria ka bërë me dije se ka ndërmend që ta dorëzojë dosjen paraprake të çështjes, pavarësisht prej ecures së hetimeve të palës mbrojtëse. Prokurorja Valeria Bolici ka deklaruar se të akuzuarit ngarkohen për krime që pretendohet të jenë kryer përmes shfaqjeve të tyre në konferenca për shtyp. Prandaj, sipas saj, përgatitja e mbrojtjes nuk mund të kufizohet me pandemi. "Në rrethana specifike të kësaj çështje, ku aktakuza pretendon se të akuzuarit kanë kryer krime përmes deklaratave apo shfaqjeve të tyre në publik, atëherë përgatitja e mbrojtjes nuk mund të kufizohet edhe aq me pandemi. Lidhur me këtë, afati i propozuar për parashtrimin e dosjes paraprake nga mbrojtja duket se nuk përputhet me nevojën për një zhvillim të përshtetshëm të procesit gjyqësor", ka deklaruar ajo. Dosja paraprake përmban për çdo akuzë një përmbledhje të provave, të cilat Prokurori i Specializuar synon t'i paraqesë në lidhje me kryerjen e veprës penale të pretenduar.

### Mbrojtja ankohet për nxjerrjen e materialeve

Gjatë seancës, avokatët e Gucatit dhe ata të Haradinajt janë ankuar në prokurorinë për nxjerrje të materialeve. Avokati i Gucatit, Jonathan Rees, ka deklaruar se një material prej 4 000 faqesh, që është konfidencial, nuk është nxjerrë në mënyrën e duhur nga prokuroria.

Ankesa për mënyrën e nxjerrjes së materialeve ka pasur edhe avokati i Haradinajt, Toby Cadman. "Unë shpreh shqetësimet e mia lidhur me mungesën e një dialogu konstruktiv dhe mënyrës shpërfillëse të prokurorisë që ajo ka shfaqur deri më tani", ka deklaruar ai.

Mirëpo prokurorja i ka hedhur poshtë këto pretendime, duke thënë se kanë përmbyshur obligimet e tyre sa i përket nxjerrjes së materialeve.

Mbrojtësi i Gucatit, Jonathan Rees, ka deklaruar se Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk e ka qartësuar nëse ka intervistuar dhjetë dëshmitarë që ka përmendur në konferencën paraprake. Por, prokurorja

Valeria Bolici ka deklaruar se ka dëshmitarë që prokuroria ka ndërmend që t'i thërrasë për dëshmi.

Në nëntor të vitit të kaluar, kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati dhe nënkryetari i kësaj organizate, Nasim Haradinajt, janë arrestuar në Prishtinë dhe janë dërguar në Hagë. Më 11 dhjetor 2020 gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, ka konfirmuar aktakuzën ndaj Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt. Veprat penale, që rëndojnë ndaj Gucatit dhe Haradinajt, sipas Dhomave të Specializuara, dyshohet se janë kryer në periudhën 7-25 shator 2020.

Sipas aktakuzës, Gucati dhe Haradinajt "zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe nëpërmjet shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet sociale". Gucati dhe Haradinajt janë deklaruar të pafajshëm për akuzat e ngritura.

## Tre të vdekur dhe 461 raste të reja me Covid në 24 orët e fundit

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur tre persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Po gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur 461 raste të reja dhe janë shëruar 319 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 3 138 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 461 raste



pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 3 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e të vdekurve janë nga komunat:

Fushë-Kosovë 1 rast (80 vjeç), Gjakovë 1 rast (85 vjeç), Pejë 1 rast (83 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 67 469 raste nga

294 985 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 1 582 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 319 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 58 919 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 968", ka njoftuar IKShPK-ja, duke bërë me dije se Prishtina prin me numrin më të madh të rasteve të reja me Covid. "Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 179 raste, Gjakovë 34 raste, Pejë 28 raste, Podujevë 24 raste, Prizren 24 raste, Fushë Kosovë 22 raste, Mitrovicë 21

raste, Ferizaj 17 raste, Vushtrri 16 raste, Lipjan 15 raste, Viti 12 raste, Gjilan 10 raste, Obiliq 9 raste, Rahovec 9 raste, Drenas 7 raste, Malishevë 5 raste, Kaçanik 4 raste, Klinë 4 raste, Deçan 3 raste, Kamenicë 3 raste, Suharekë 3 raste, Dragash 2 raste, Istog 2 raste, Mamushë 2 raste, Shtime 2 raste, Skenderaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë dhe Kllokot", ka njoftuar IKShPK-ja. Më këtë rast, IKShPK-ja ka kërkuar nga institucionet dhe qytetarët që t'i zbatojnë në mënyrë strikte masat kundër Covidit.



KOMISIONI PËR POLITIKË TË JASHTME I PARLAMENTIT EVROPIAN KA MIRATUAR RAPORTIN PËR KOSOVËN

# Parlamenti Evropian: Pavarësia e Kosovës, e pakthyeshme

Eurodeputetët edhe një herë kanë konstatuar se pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme. Në raportin e miratuar për Kosovën të Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian, ata u kanë bërë thirrje pesë shteteve të BE-së të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, që ta bëjnë një gjë të tillë. Sipas tyre, njohja nga të gjitha shtetet e BE-së do të ishte në dobi të normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 SHKURT - Me 50 vota për, 10 kundër dhe 9 abstenime, Komisioni për Politikë të Jashtme i Parlamentit Evropian ka miratuar raportin për Kosovën në të cilin vlerësohet edhe një herë se pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme.

Në raportin e përgatitur nga eurodeputetja Viola Von Cramon-Taubadel, Parlamenti Evropian u ka bërë thirrje edhe një herë pesë shteteve të Bashkimit Evropian, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, që ta bëjnë një gjë të tillë.

Në një komunikatë të lëshuar nga PE-ja pas këtij votimi, është thënë se njohja e pavarësisë së Kosovës nga Spanja, Greqia, Sllovakia, Rumania dhe Qipro, do të ishte në dobi të normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

“Deputetët nënvizojnë se pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme dhe njohja nga të gjitha shtetet e BE-së do të ishte në dobi të normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë”, është thënë në komunikatë.

Në këtë raport, po ashtu, deputetët evropianë kanë përsëritur edhe thirrjen për liberalizimin e vizave për Kosovën, pasi Komisioni Evropian prej vitesh ka konstatuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara.

Para se të votohej për raportin si tërësi, ishte votuar për amendamentet e veçanta të prezantuar nga deputetët e Parlamentit Evropian.

Raportuesja për Kosovën, Viola Von Cramon, e cila edhe e kishte përpiluar tekstin e raportit, është shprehur e kënaqur me miratimin e këtij raporti. “Ky rezultat tregon

se shumica në Parlamentin Evropian e mbështesin Kosovën në rrugën evropiane. Ne qartë shohim potencialin e këtij vendi, por edhe të Bashkimit Evropian. Por, ende ka punë përpara për Kosovën. Së pari na duhet një stabilitet politik për zbatimin e reformave të nevojshme”, ka thënë Von Cramon teksa ka komentuar votimin për raportin për Kosovën. Ajo ka thënë se edhe BE-ja ka detyra të shtëpisë për të bërë në raport me Kosovën, duke përmendur liberalizimin e vizave. “Prandaj kemi bërë thirrje për Këshillin (e BE-së) që, më në fund, ta miratojë vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës”, ka thënë Von Cramon. Raporti evidenton edhe sfidat me të cilat vazhdon të përballet Kosova.

Në raport, Kosova kritikohet për mungesë të përparimit të duhur

në shumë fusha, sidomos në zbatimin e prioriteteve të agjendës së reformave evropiane. Deputetët shprehën keqardhje për vazhdimin e jostabilitetit politik dhe u kanë bërë thirrje të gjitha forcave politike në Kosovë që të angazhohen për reformën e sistemit politik, në mënyrë që të përmirësohet qartësia ligjore dhe procesi i formimit të qeverisë. Po ashtu, kërkohet që Kosova ta sigurojë reformën e sistemit gjyqësor në mënyrë që ai të jetë më transparent, efikas dhe pa ndërhyrje politike. Në të njëjtën mënyrë, kërkohet edhe reforma e administratës publike.

Në raport përmendet se Kosova ka një “mjedis pluralist dhe të gjallë mediatik”, por kërkohet që të garantohet transparencë e plotë e pronësisë së mediave dhe pavarësia dhe liria nga ndikimet politike.

Anëtarët e Parlamentit Evropian kanë përsëritur thirrjet që raportet e Kosovës me Serbinë të mbeten prioritet dhe kusht për avancimin e të dyja vendeve në procesin e integritimeve evropiane.

Ata kanë kërkuar nga qeveritë e të dyja shteteve që të përmbahen nga çfarëdo veprime që mund ta

pengojnë krijimin e besimit mes palëve, që do ta vinin në rrezik vazhdimin konstruktiv të dialogut. Nga Kosova është kërkuar që të përballet edhe me problemet e brendshme në qasjen e saj ndaj dialogut me Serbinë që ndërmjetësohet nga BE-ja.

## Eurodeputetët kritikojnë fushatën kundër BE-së në Serbi

Komisioni për Politikë të Jashtme i Parlamentit Evropian ka miratuar edhe raportin për Serbinë. Eurodeputetët edhe Serbisë i kanë dërguar porosi që të jetë konstruktive në dialog me Kosovën.

Ata kanë kritikuar fushatën kundër BE-së në Serbi, përfshirë edhe në mediat e financuara nga shteti. Ata kanë kërkuar që udhëheqësit politikë në Serbi të shprehin qartë dhe pa hezitim për orientimin pro evropian të Serbisë. Po ashtu, eurodeputetët kanë kërkuar nga Serbia që t'u bashkohet qëndrimeve të BE-së në çështjet e politikës së jashtme. Raportet e Komisionit për Politikë



# Mos zgjedhja e presidentit prodhon krizën më të thellë kushtetuese

PRISHTINE, 24 SHKURT - Zgjedhjet e 14 shkurtit nuk kanë prodhuar një situatë krejtësisht të qartë për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës. Njohësit e Kushtetutës dhe analistët politikë, Visar Morina dhe Albert Krasniqi, thonë se vendi mund të rreshqasë në një krizë të thellë kushtetuese në rast se skadon mandati i ushtruesit të detyrës i presidentit dhe Kuvendi nuk arrin ta votojë presidentin e ri brenda afatit kushtetues. Neni 86 i Kushtetutës së Kosovës parasheh që zgjedhja e presidentit të bëhet jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit të presidentit aktual. Vjosa Osmani, që aktualisht është ushtruese e detyrës e presidentit, mund ta mbajë këtë pozitë më së largu deri më 5 maj të këtij viti. Pika katër e nenit 86 thotë se zgjedhja e presidentit bëhet me dy të tretat e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit. Nëse në votimin e tretë asnjëri kandidat nuk merr shumicën e votave (61), Kuvendi shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditësh. Osmani ka ardhur në këtë pozitë pas dorëheqjes së ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, më 5 nëntor 2020, kur i është konfirmuar aktakuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit nga Gjykata Speciale me seli në Hagë.

## Skenari që dërgon te kriza

Profesori i së Drejtës Kushtetuese, Visar Morina, thotë se dështimi për ta zgjedhur presidentin shkakton krizë të thellë kushtetuese. Sipas tij, pozita e ushtruesit të detyrës së presidentit nuk mund të mbahet më tepër se gjashtë muaj nga marrja e detyrës. "Nëse eventualisht, brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjidhet presidenti i Republikës së Kosovës, atëherë Kuvendi shpërndahet dhe vendi shkon në zgjedhje të sërishme parlamentare", thotë Morina për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, ky do të ishte një skenar jo i duhur, pasi përbën "manifestim të pastër të mungesës së stabilitetit politik, respektimit të vullnetit politik të qytetarëve dhe demokracisë në përgjithësi". Kriza më e thellë kushtetuese, sipas profesorit Morina, mund të shkaktohet nëse skadon mandati i u.d. së presidentit, Vjosa Osmani, dhe nuk zgjidhet presidenti i ri. "Kushtetuta e Kosovës nuk ofron asnjë referencë normative se cili organ gëzon të drejtën e caktimit të datës së zgjedhjeve në mungesë të një presidenti legjitim, në pikëpamje kushtetuese dhe

demokratike. Në një situatë të tillë, zgjedhjen sigurisht se do të duhej kërkuar vetëm te një vendim interpretues i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës", thotë Morina.

## Kompromisi për presidentin, i pashmangshëm

Albert Krasniqi, hulumtues politikash në organizatën "Demokraci Plus", thotë për "Radion Evropa e Lirë" se në bazë të rezulttit preliminar zgjedhor, asnjë nga partitë nuk do të jetë në gjendje që ta formojë qeverinë dhe ta zgjedhë presidentin. "Kompromisi në mes të partive politike është i pashmangshëm nëse synohet që brenda kësaj legjislature të re të zgjidhet presidenti dhe të shmanget një vakuum institucional i cili mund të shkaktohet. Nuk ka kohë për kurrfarë kombinimesh të tjera, por edhe kalkulime të partive politike, për ta maksimizuar votën e tyre përmes përsëritjes së zgjedhjeve", thotë Krasniqi. Krasniqi thotë se situata aktuale është një mundësi e mirë që të zgjidhet një president konsensual, që do t'i përfaqësonte interesat e të gjithëve, e jo t'i shërbejë vetëm një subjekti politik. Sipas rezultateve preliminare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 47.85 për qind të votave, Partia Demokratike e Kosovës 17.41 për qind, Lidhja Demokratike e Kosovës 13.08 për qind dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 7.43 për qind. Me këtë rezultat, Lëvizja Vetëvendosje pritet t'i ketë 56-57 deputetë në legjislaturën e ardhshme të Kuvendit të Kosovës. Për ta bërë qeverinë, Lëvizjes Vetëvendosje i duhen 61 vota. Për të 'iisur procedurat për zgjedhjen e presidentit, në këtë rast Vjosa

Osmanit si kandidate, në votimin e parë nevojiten 80 deputetë të pranishëm në sallë.

## A obligohen deputetët që të marrin pjesë në votimin e presidentit?

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) duhet që fillimisht t'i certifikojë rezultatet e zgjedhjeve të 14 shkurtit, për t'u thirrur pastaj seanca konstituive e Kuvendit, në të cilën konfirmohen mandatet e deputetëve. Pas kësaj, konfirmohen grupet parlamentare dhe zgjidhet kryetari i Kuvendit si dhe anëtarët e kryesisë. Në momentin e përfundimit të këtyre procedurave, institucionet procedojnë me çështjen e mandatarit dhe formimit të qeverisë. Pas zgjedhjeve të 14 shkurtit dhe pas publikimit të rezultateve preliminare, zyrtarë të Lëvizjes Vetëvendosje, parti kjo që i ka fituar zgjedhjet, kanë përfunduar mundësinë që të kenë në koalicion ndonjë nga partitë shqiptare. Lëvizja Vetëvendosje ka garuar në zgjedhje me Albin Kurtin si kandidat për kryeministër dhe me Vjosa Osmanin si kandidate për presidente. Por, bazuar në rezultatet preliminare, Lëvizja Vetëvendosje duket se do të ketë problem që ta bëjë kuorumin e nevojshëm prej 80 deputetësh gjatë seancës në të cilën votohet presidenti. Profesori i së Drejtës Kushtetuese, Visar Morina, thotë se çështja e kuorunit rregullohet me disa nene të Kushtetutës. "Ka disa nene kushtetuese që rregullojnë këtë aspekt, sikurse është neni 70 i Kushtetutës së Kosovës, i cili përcakton se 'deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit' dhe neni 74 që parasheh se 'deputetët e

Kuvendit të Kosovës do ta ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe sipas Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores së Punës së Kuvendit", thotë Morina. Çështja e qëndrimit në sallë apo jo është theksuar në një vendim të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2011, në kohën kur ishte kontestuar zgjedhja e Behgjet Pacollit në pozitën e presidentit. Pacollin e kishte rrëzuar Gjykata Kushtetuese, pasi në raundin e parë të votimit, të pranishëm në sallë ishin vetëm 67 deputetë nga 80 sa duhej për ta pasur kuorumin e nevojshëm. Përkundër faktit që nuk kishte kuorum, asokohe Jakup Krasniqi, si kryetar i Kuvendit, pas raundit të tretë të votimit, ka konkluduar se Behgjet Pacolli është zgjedhur president i Kosovës. "Të 120 deputetët e Kuvendit duhet të ndihen të obliguar sipas Kushtetutës, Ligjit për deputetët, Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Kodit të sjelljes, që të marrin pjesë në seancat plenare të Kuvendit", thuhet në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje. Sa i takon situatës së tanishme, profesori i së Drejtës Kushtetuese, Visar Morina, thotë se "refuzimi për të qëndruar në sallë dhe për të votuar, manifeston mungesë të thellë të konsideratës ndaj votuesve dhe patriotizmit kushtetues, të cilit deputetët e Kosovës i janë zotuar me rastin e betimit si deputetë të Kuvendit të Kosovës". Aktualisht, nuk ka një datë të saktë se kur do të përfundojë procesi i numërimit dhe rinumërimit të votave, në mënyrë që KQZ-ja ta bëjë certifikimin e rezultateve. Nga ky proces do të varet edhe thirrja e seancës konstituive të Kuvendit e më pas formimi i qeverisë si dhe zgjedhja e presidentit të ri të Kosovës.

të Jashtme për Serbinë dhe Kosovën, pas miratimit, dërgohen në seancë plenare, në formë të propozim-rezolutës, për t'u votuar më vonë në pranverë. Siç dihet rezolutat e Parlamentin Evropian shprehin qëndrime politike të këtij institucioni të BE-së, por nuk janë ligjërisht të obligueshme për vendet anëtare.

## Mandl: Janë dhënë mesazhe të forta për liberalizimin e vizave dhe dialogun me Serbinë

Eurodeputeti austriak Lukas Mandl një ditë me parë ka bërë me dije se në raportin për Kosovën të Komisionit për Punë të Jashtme në Parlamentin Evropian kanë dhënë mesazhe të forta mbi liberalizimin e vizave, njohjen, dialogun Kosovë - Serbi. "Ne votuam në Komitetin për Punë të Jashtme në Parlamentin Evropian, Raportin për Kosovën që unë e kam negociuar në emër të Grupit EEP. Ne kemi dhënë mesazhe të forta mbi liberalizimin e vizave, njohjen, dialogun Kosovë - Serbi dhe perspektivat për të rinjtë në digjitalizimin dhe fusha të tjera", ka shkruar Mandl në "Twitter".



## KEDS-i do të investojë në vlerë prej 6.3 milionë eurosh në Gjakovë

**GJAKOVË, 24 SHKURT (ER)**- Këtë vit KEDS-i do të investojë në vlerë prej 6.3 milionë eurosh në Gjakovë. Projekti përfshin rehabilitimin e tensionit të mesëm, investim ky i cili do të sigurojë shërbime më të mira të energjisë elektrike për 12 mijë konsumatorë të Komunës së Gjakovës. Për të biseduar në detaje për këtë investim, kryetari i komunës, Ardian Gjini, ka pritur në takim drejtorin për

Investime në KEDS, Hasan Oz, drejtorin e KEDS-it në Gjakovë, Kreshnik Sokoli dhe këshilltarin ekzekutiv të kompanisë, Avni Alidemaj. Kryetari Gjini është shprehur se ky projekt është jashtëzakonisht i rëndësishëm për komunën, duke theksuar mbështetjen e tij dhe të institucionit që ai drejton për finalizimin e suksesshëm të punimeve të cilat nisin në prill të këtij viti.



## KFOR-i dhe FSK-ja e vlerësojnë stabile situatën e sigurisë në Podujevë



**PODUJEVË, 24 SHKURT (ER)** - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Podujevës (KKS) ka mbajtur mbledhjen e rregullt në të cilën ka shqyrtuar situatën e sigurisë dhe gjendjen me pandeminë Covid-19 në komunë. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë mbledhje të cilën e kryesoi kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, ka shqyrtuar gjendjen e sigurisë në komunë dhe është informuar lidhur me gjendjen e pandemisë

Covid-19 dhe ka miratuar planin e punës së KKS për vitin 2021 dhe informatën për aktivitetet e KKS për vitin 2020.


Lidhur me gjendjen e sigurisë në komunë, komandanti i Stacionit Policor në Podujevë, major Isak Ejupi, ka thënë se gjendja e përgjithshme e sigurisë është e mirë. Komandant Ejupi, duke raportuar për gjendjen e sigurisë, ka thënë se në periudhën e fundit është shënuar rënie e veprave penale kundër pasurisë-

vjedhjeve. Shqetësuese komandant Ejupi e paraqiti rritjen e aksidenteve në komunikacion, për çka tha se do të ndërmarrin masa parandaluese duke shtuar patrullimet e policisë në rrugë. Ai, gjithashtu, tha se me qëllim të vetëdijesimit dhe parandalimit të përdorimit të substancave narkotike, janë duke mbajtur ligjërata nëpër shkolla. Gjendjen e sigurisë në territorin e Komunës së Podujevës e vlerësuan të qetë edhe përfaqësuesit e KFOR-it dhe të FSK-së.

## Haskuka infektohet me Covid

**PRIZREN, 24 SHKURT (ER)**- Kryetari i komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, është infektuar me Covid-19. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se do të qëndrojë në vetizolim. "Nga fundjava e kaluar kam pasur disa simptoma të Covid-19, si temperaturë, dhembje të trupit dhe të nyjeve, kollitje dhe ethe. Në testin e parë pata rezultuar

negativ, sidoqoftë duke i ditur simptomat, mbeta në vetizolim dhe sot pasi që e përsërita testin rezultova pozitiv për Covid-19. Për këtë arsye, në ditët në vijim do të qëndrojë në vetizolim. Me këtë rast apeloj tek të gjithë ju, që të keni kujdes dhe t'i respektoni masat kundër pandemisë, të mbronni veten dhe familjet tuaja", ka shkruar Haskuka.



## Kryeprokurori Kadriu, Dogana dhe AVUK-u bashkëpunojnë në regjionin e Gjilanit

**GJILAN, 24 SHKURT (ER)** - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Arben Kadriu, ka pritur të mërkurën në takim udhëheqës nga Dogana dhe AVUK-u për regjionin e Gjilanit. Ky takim kishte për qëllim bashkëpunimin mes këtyre institucioneve për trajtimin e rasteve që ndërlihen me parandalimin dhe luftimin e

kontrabandës me mallra. Gjithashtu, mes tyre u diskutua edhe për mundësinë e trajtimit të mallrave me origjinë bimore për shkak të dëmit material, për të cilat ekziston rreziku i prishjes. Në fund të takimit të pranishmit u shprehën të gatshëm për bashkëpunim dhe u pajtuan që takime të tilla të realizojnë edhe më tutje.



# Qeveria miraton programin për komunitetet

EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 SHKURT- Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës të mërkurën, në të cilën ka miratuar disa vendime nga fushat e përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore të saj. Me vendimin e parë është miratuar Programi për Komunitete, i cili përcakton kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe transfereve nga buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, me qëllim të mbështetjes dhe promovimit të të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.

Ky program do të zbatohet nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit dhe nga personat fizikë dhe juridikë që do të jenë përfitues të subvencioneve. Programi do ta garantojë lirinë e pjesëmarrjes në konkurrim;

mosdiskriminim dhe trajtim të barabartë të aplikimeve; transparencë të procedurave dhe vendimmarrjes për aplikuesit; përputhshmëri me objektivat e ndarjes së subvencionit; paanshmëri në shqyrtimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit; ndalim të financimit për të njëjtin përfitues më shumë se një herë brenda një viti; dhe ndalim të subvencionimit të të njëjtit projekt nga organizata të tjera buxhetore apo donatorët, me përjashtim të rasteve të bashkëfinancimit.

Kabineti qeveritar ka shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Mbrojtjes për pezullimin e nenit 20 të Rregullores Nr. 23/2020 për Atashetë e Mbrojtjes deri në plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të shfrytëzimit të buxhetit të ndarë për mbulimin e shpenzimeve të planifikuara për atashetë e mbrojtjes në kuadër të



misioneve diplomatike, përkatësisht transferimit të fondeve buxhetore, Ministria e Mbrojtjes në konsultim me Thesarin do të lejojë që përmes atashetë të sigurohet qasja në të gjitha transaksionet bankare për Ministrinë e Mbrojtjes dhe për Thesarin. Kjo do të sigurojë që fondet në këto llogari do të shfrytëzohen ekskluzivisht për qëllime zyrtare dhe për

realizimin e shpenzimeve të planifikuara për atashetë e mbrojtjes.

Në këtë mbledhje është miratuar edhe vendimi për zbatimin e sanksioneve ekonomike ndërkombëtare ndaj entiteteve dhe personave fizikë, të përcaktuar sipas listave të sanksioneve, të vendosura nga: Organizata e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian

dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto sanksione zbatohen me qëllim të ruajtjes së interesave kombëtare të Republikës së Kosovës dhe kontributit aktiv për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare. Sanksionet do të vazhdojnë deri në një vendim tjetër të qeverisë dhe varësisht nga rrethanat mund të përditesohen.

## Lansohet manuali për akreditim për ekspertë ndërkombëtarë

EPOKA  
ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 24 SHKURT- - Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe projekti Higher Education, Research and Applied Sciences Plus lansuan të mërkurën manualin për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programet e studimit nga ekspertë ndërkombëtarë, një manual trajnimi i hartuar me qëllim të ofrimit të udhëzimeve të bazuara në praktikë për ekspertët ndërkombëtarë të vlerësimit të angazhuar nga AKA-ja për kryerjen e vlerësimit të jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në Kosovë.

Drejtori i AKA-së, Naim Gashi, ka thënë se lansimi i këtij projekti ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve të Agjencisë së Akreditimit për vlerësimin e jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë, gjithashtu plotëson një nga kriteret për kthimin tonë në ENQA dhe EQAR. "Me këtë produkt, projekti 'Heras Plus' dhe donatorët austriakë po kontribuojnë në sigurimin e



cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë. Manuali për ekspertët e jashtëm që marrin pjesë në procesin e vlerësimit në Kosovë, rrit cilësinë e shërbimeve tona, u shpjegon me hollësi ekspertëve standardet e AKA-së si dhe kontekstin e Kosovës", ka deklaruar Gashi.

Gashi ka falënderuar projektin "Heras Plus", donatorin kryesor

Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si dhe partnerët e tjerë të konsorciumit zbatues të projektit, për financimin e këtij projekti me rëndësi kaq të madhe për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, si dhe për sistemin e arsimit të lartë në Kosovë.

Udhëheqësi i projektit të

"Heras Plus", Aqim Emurli, ka theksuar se mbështetja e AKA-së për zhvillimin e manualit që kanë promovuar është vazhdimësi e kontributit që ofron projekti "Heras Plus" për mbështetjen e arsimit të lartë në Kosovë në përgjithësi. "Gjithashtu, është një tregues i përkushtimit të donatorëve dhe zbatuesve të projektit në fushën e avancimit të

përgjithshëm institucional të AKA-së, por edhe të agjendës evropiane të Kosovës në fushën e arsimit të lartë. Në këtë fazë, fokus kryesor i projektit sa iu përket aktiviteteve që ndërlihen me AKA-në, mbetet angazhimi për rikthimin e AKA-së në Asociacionin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA)", ka thënë Emurli.

Manuali është tejet i rëndësishëm pasi Agjencia do ta përdorë atë për t'i trajnuar ekspertët lidhur me tema relevante të procesit të akreditimit si dhe lidhur me të kuptuarit e kontekstit të arsimit të lartë dhe proceseve relevante.

Mbështetja e projekti "Heras Plus" për zhvillimin e këtij manuali përbën një nga aktivitetet që janë pjesë e memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar në nëntor 2020 nga të dyja palët me qëllim të ofrimit të mbështetjes për ndërtimin e kapaciteteve të AKA-së dhe për përmbushjen e kriterëve për kthimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim në ENQA.

## Mbi 500 operacione në Urologji gjatë vitit 2020

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER)- Mjekët e Klinikës së Urologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës gjatë vitit 2020 kanë kryer 541 operacione, pavarësisht prej situatës së krijuar me pandeminë Covid-19.

Në sajë të raportit vjetor të

punës, prej tyre janë 140 intervenime të hapura dhe 361 intervenime endourologjike (ndërhyrje përmes kanalit të traktit urinar).

Gjatë kësaj periudhe kohore, po ashtu, mjekët kanë kryer 918 ekzaminime endoskopike dhe kanë ofruar 70 shërbime

urodinamike.

Vitin e kaluar janë bërë edhe 204 biopsi të prostatës, 98 nefrostoma dhe 618 ndërhyrje ESWL (thyerje të gurëve). Numri i vizitave ambulatorie ka shkuar në 2 832, kurse janë dhënë 1 320 shërbime diagnostike (EHO).



## Hykmete Bajrami jep dorëheqje nga detyra e ministres së Financave

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER)- Hykmete Bajrami, ministre në detyrë e Financave, ka kërkuar nga kryeministri Avdullah Hoti lirim nga kjo detyrë. “Me kërkesën time, jam liruar nga pozita e ministres së Financave në detyrë. Aktivitetin tim politik do ta vazhdoj si deputete e LDK-së në Kuvendin e Republikës së Kosovës sapo të certifikohen rezultatet e

zgjedhjeve. Me këtë rast, dëshiroj ta falënderoj kryeministrin Hoti për bashkëpunimin e ngushtë dhe për mbështetjen e përhershme gjatë kësaj periudhe. Po ashtu, falënderoj kryetarin Isa Mustafa për besimin e dhënë për të qenë në krye të një dikasteri të rëndësishëm sikurse Ministria e Financave. Gjatë kësaj periudhe si

udhëheqëse e Ministrisë së Financave kam bashkëpunuar ngushtë me stafin e MF-së. Së bashku kemi kaluar nëpër mjaft sfida dhe zhvillime të rëndësishme në përpjekje për t’u përballur me pasojat e pandemisë”, ka shkruar Bajrami në llogarinë e vet në “Facebook”. Hoti ka emëruar Agim Krasniqin ministër në detyrë të Financave.



## Certifikohen 53 auditorë të energjisë



**EPOKA E RE**

**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 SHKURT- Ministri në detyrë i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj dhe rektori i Universitetit të Prishtinës (UP), Naser Sahiti, të mërkurën kanë ndarë certifikatat e auditorëve të energjisë.

Ministri Nitaj ka njoftuar se janë trajnuar 53 kandidatë, por në pamundësi që të jenë të

pranishëm të gjithë kandidatët për shkak të gjendjes me pandeminë, kanë ftuar tre nga ta që në mënyrë simbolike t’u ndahen certifikatat. “Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka angazhuar Universitetin e Prishtinës për trajnimin e auditorëve për procesin e performancës të vlerësuesve dhe certifikuesve të ndërtesave, projekt ky jashtëzakonisht i rëndësishëm që është ndihmuar nga GIZ-i gjerman.

Në këtë fazë të parë me punën e shkëlqyeshme të Universitetit të Prishtinës, është arritur që të trajnohen 53 auditorë”, ka thënë ministri Nitaj. Rektori Sahiti ka thënë se ky bashkëpunim dëshmon se janë të gatshëm për zgjerim të aktiviteteve edhe në fusha të tjera. “Si rezultat i bashkëpunimit ne realizuam trajnimin ku certifikuam auditorë të energjisë. Është moment shumë i rëndësishëm

të tregojmë se ne jemi të gatshëm për zgjerim edhe në fusha të tjera”, ka thënë Sahiti. Kurse kandidati i certifikuar, Fahrush Azemi, tha se për një zhvillim të qëndrueshëm, segmenti i energjisë është shumë i rëndësishëm dhe, po ashtu, theksoi se duhet të merren masa në shumë objekte në Kosovë. Projekti i certifikimit të auditorëve të energjisë është organizuar nga Agjencia e

Kosovës për Efiçencë të Energjisë, është financuar nga qeveria gjermane përmes GIZ-it, ndërsa trajnimi është kryer nga UP, ku janë trajnuar 53 kandidatë, nga ta 17 janë arkitektë, 16 inxhinierë të ndërtimtarisë, 12 inxhinierë të elektros dhe tetë inxhinierë të makinerisë.

Tre kandidatët që morën certifikatat janë Fahrush Azemi, Krenare Shkodra dhe Njomza Blaku.

## PD-ja prezanton planin për energjinë, Basha: Ulim faturat për 70 për qind të bizneseve

PRISHTINË, 24 SHKURT- Partia Demokratike e Shqipërisë (PD) ka prezantuar programin për energjinë. Lideri i kësaj partie, Lulzim Basha, ka premtuar ulje të çmimit të naftës dhe të energjisë elektrike. Sipas Bashës, fatura e energjisë elektrike do të ulet për 70 për qind të familjeve shqiptare duke ngritur një sistem faturimi me dy fasha dhe duke ulur çmimin e energjisë për ata që

konsumojnë deri në 300 kv/orë në muaj. Po ashtu, Basha ka premtuar edhe liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, duke u dhënë konsumatorëve mundësinë të zgjedhin vetë se te cili operator do ta blejnë energjinë. Një tjetër pikë e prezantuar nga Basha ishte edhe bashkimi i tregut të energjisë me Kosovën. “Unë angazhohem për bashkimin e tregjeve të

energjisë me Kosovën duke kombinuar prodhimin nga TEC-et në Kosovë për energji elektrike bazë, ndërsa ajo e prodhuar në Shqipëri do të përdoret për ta mbuluar kërkesën në kohën e pikut”, ka thënë lideri i opozitës, duke shtuar se do të nxitet edhe prodhimi i energjisë nga burime të gjelbra dhe të pastra me fokus energjinë hidrike dhe atë të erës.





# 12 të arrestuar, 400 mijë euro të sekuestruara, me dyshimet për ryshfet në subvencionet bujqësore



PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Dy qytetarë dhe dhjetë zyrtarë të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, që funksionin në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë në Kosovë, janë arrestuar në aksionin e Policisë së Kosovës që ka nisur në orët e para të

mëngjesit të së mërkurës.

Të arrestuarit mësohet se kanë pozita të ndryshme në kuadër të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. Dyshimet mbi ta lidhen me marrje ryshfeti.

Aksioni policor është zhvilluar në disa komuna si në Prishtinë, Istog

dhe Pejë.

Policia ka kryer bastisje edhe në shtëpitë e personave të arrestuar dhe, sipas kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, bëhet fjalë për një shumë të parave deri në 400 000 euro. "Të njëjtët dyshohen për disa vepra penale,

për keqpërdorim të subvencioneve, për marrje të ryshfetit dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare", ka thënë Lumezi në një konferencë për media.

Ai ka bërë me dije se në muajin janar ka filluar grumbullimi i provave dhe informacioneve

lidhur me këtë rast për ryshfet në subvencionet bujqësore. Lumezi ka thënë se, pos 400 000 eurove të sekuestruara, gjatë këtyre aksioneve kanë sekuestruar vetura, kompjuterë, llap-top, telefona etj., të cilat, sipas tij, do t'u shërbejnë për hetime.

## Miratohen aplikacionet për grante investuese

Prishtinë, 24 shkurt (ER)- Të mërkurën është mbajtur takimi i radhës i Komisionit për Planifikim Strategjik, i kryesuar nga kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti. Në takim u miratuan tri aplikacione me të cilat Kosova do të aplikojë në raundin e 25-të të asistencës teknike të Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF), për t'i zhvilluar projektet sikurse "Rehabilitimi dhe ndërtimi i infrastrukturës për mbrojtjen nga vërshimet përgjatë lumenjve Drini i Bardhë, Sitnica dhe Morava e

Binçës", "Ndërtimi i hidro sistemit "Ibër-Lepenc" dhe për "Përmirësimin e infrastrukturës në institucionet e arsimit të lartë".

Po ashtu, u miratua edhe aplikacioni për raundin 6-të të granteve investuese të WBIF, për Autostradën e Paqes, seksionin Besi-Merdar, në vlerë prej 38 milionë eurosh. Këto mjete financiare pritet t'i shtohen grantit me vlerë të njëjtë tashmë të miratuar në dhjetor nga WBIF, dhe kjo pritet të çojë vlerën totale të përfitimt për këtë projekt në 76



milione euro nga grantet e WBIF ose 40 për qind e kostos

totale të projektit. Asistenca teknike e përfitur

për këto projekte do të ndihmojë në përgatitjen për kryerjen e investimeve, ndërsa grantet investuese do të zbatohen drejtpërdrejt. Pjesa tjetër e investimeve do të mbulohet nga huat e ofruara nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Evropiane për Investime.

Aplikacionet e miratuara do të jenë në funksion të zbatimit të përfitimt që Kosova do të ketë nga Plani për Ekonomi dhe Investime i BE-së për Ballkanin Perëndimor.



## Tenori Ramë Lahaj pjesë e kastit të operës 'La Traviata' në Sidnei

Tenori shqiptar Ramë Lahaj ka nisur provat përgatitore për shfaqjen e tij të radhës, ku pas rreth një muaji do të jetë pjesë e kastit të operës "La Traviata" në Gjirin e Sidneit.

"Pak më shumë se një muaj deri në hapjen e natës së parë, artistët tanë më në fund janë përsëri në punë, gati për të sjellë në jetë operën më të preferuar në botë, në mjedisin më të bukur të Sidneit." – citohet nga përfaqësuesi i Operës së qytetit të Sidneit në Australi.

Në moshën 21-vjeçare nisi

stërvitjen profesionale muzikore dhe një vit më vonë filloi studimet në Akademinë e Arteve në Tiranë, ku dhe u diplomua si nxënës i më i dalluar në vitin 2008.

Në moshën 21-vjeçare, tenori i ardhshëm nisi të ushtrohej në muzikë. Skena gjermane ishte ajo që do të mundësonte tenorin që të tregonte performancën e tij. Tenori erdhi me një rol tjetër të rëndësishëm për repertorin e tij, rolin e Rodolfos në opera (La bohème / La Bohème) në Dortmund.



## Naim Spahiu emërohet zëvendësues i Drejtorit të Galerisë Kombëtare të Kosovës



Piktori Naim Spahiu është emëruar si zëvendësues i Drejtorit të Galerisë Kombëtare të Kosovës, shkruan KultPlus.

Ky vendim është marrë më

datë 22.02.2021 dhe sot GKK ka njoftuar përmes faqes zyrtare në facebook.

Naim Spahiu lindi më 18 mars 1968 në Mitrovicë, Kosovë. Më 1998 përfundon

Akademinë e Arteve në Prishtinë, Kosovë, ndërsa në vitin 2002 diplomohet si piktor.

2005 Përfundon post-diplomimin në Prof. Esat Valla

në Prishtinë. Deri në emërimin e tij si zëvendësues i Drejtorit të Galerisë Kombëtare të Kosovës, Spahiu ishte koordinator për ekspozitat në po në këtë institucion.

## Hillary Clinton shkruan romanin e parë



NJU JORK, 24 SHKURT- Ish-sekretarja amerikane e Shtetit, Hillary Clinton, ka shkruar romanin e saj të parë. "State of terror", i shkruar në partneritet me autoren kanadeze, Louise Penny,

do të publikohet më 12 tetor të këtij viti. Romani eksploron një botë "të diplomacisë së rrezikshme dhe të tradhtisë", ka pohuar Clinton. Bashkëpunimin me shkrimtaren Penny e cilësoi

si "ëndërr të bërë realitet". Penny tha se ka qenë "një përvojë e pabesueshme hyrja brenda Departamentit të Shtetit, brenda Shtëpisë së Bardhë dhe brenda mendjes së sekretares së Shtetit,

derisa shpërthejnë kriza me rreziqe të mëdha".

Clinton, e cila ka qenë edhe kandidatë për presidente, edhe Zonjë e Parë, është autore e disa punimeve jofiktive. "What hap-

pened", libri i saj i fundit i publikuar në vitin 2017, shpjegon se përse ka dështuar të bëhet presidente.

Brenda një jave në ShBA janë shitur 300,000 kopje të tij.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Nxehet gara për titull, katër pikë diferenca mes tri skuadrave kryesuese

Prishtina është rikthyer fuqishëm në garën për titull, pasi të mërkurën e ka mposhtur në derbi skuadrën kampione, Dritën (2-0). Tash kryeqytetasit kanë tri pikë më pak se gjilanasit dhe katër më pak se Ballkani. Sot (e enjte) zhvillohen dy ndeshjet e fundit për javën e 21-të



se ishim më lart se kundërshtari, por kishim mungesë përqendrimi. Në ndeshjen me Trepçën kemi luajtur keq, por sot kishim paraqitje të mirë dhe mendoj se na mungoi vetëm fati në këtë takim”, ka thënë pas ndeshjes trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu. Derbi tjetër i elitës në mes të Gjilanit dhe Ballkanit ka përfunduar me rezultat 1-1. Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll 0-0, kurse në minutën e 76 Mevlan Zeka nga gjuajtja e lirë e kaloi në epërsi skuadrën mysafire 0-1, por vendësit nuk u dorëzuan dhe u

rikthyen shpejt në lojë duke e barazuar rezultatin me golin e shënuar nga Darko Nikaq. Në fund të ndeshjes u akordua penalti për skuadrën e Ballkanit, por më pas gjyqtarët vendosën për anulimin e saj. Ballkani, edhe përkundër këtij barazimi, mbetet në pozitën e parë me 45 pikë, kurse Gjilani në pozitën e katërt me 31 pikë. Trepça '89, pas fitores ndaj Dritës në fundjavën e kaluar, arriti t'i marrë tri pikë të rëndësishme edhe në përbalje me Llapin (1-0). Goli i shënuar në fund të

**SUPERLIGA - Java 21**

Gjilani - Ballkani	1-1
Trepça '89 - Llapi	1-0
Prishtina - Drita	2-0

Të enjten takohen:  
13:00 Feronikeli - Drenica  
13:00 Besa - Arbëria

Tabela		Pikë
1. Ballkani	21	45
2. Drita	21	44
3. Prishtina	21	41
4. Gjilani	21	31
5. Trepça '89	21	28
6. Feronikeli	20	24
7. Llapi	21	23
8. Arbëria	20	22
9. Drenica	20	20
10. Besa	20	7

pjesës së parë nga Mohamed Darëish i ka mjaftuar 89-shit që ta fitoi ndeshjen. Trepça '89, pas kësaj fitore, është e pesta në tabelë me 28 pikë, kurse Llapi është në pozitën e shtatë me 23 pikë. Sot (e enjte) zhvillohen dy ndeshjet e radhës. Do të përballesh Feronikeli - Drenica dhe Besa - Arbëria.

**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 24 SHKURT** - Tri ndeshjet e javës së 21-të në Superligën e Kosovës në futboll kanë sjellë rezultate interesante dhe tash gara për titull është bërë edhe më interesante, pasi Prishtina e ka mposhtur Dritën e, në anën tjetër, Ballkani ka mbetur baras me Gjilani. “Është merita e futbollistëve për fitoren ndaj Dritës. Ata dhanë maksimumin. I uroj futbollistët e mi për fitoren dhe shpirtin luftarak. Ne u shpërblyem me tri pikë e që ishte edhe objektivi ynë për këtë ndeshje. Ne duhet të jemi me këmbë në tokë dhe nuk duhet të përballemi me eufori”, ka thënë pas ndeshjes trajneri i Prishtinës, Zekrija Ramadani.

Prishtina e ka fituar ndeshjen e tretë direkte me skuadrën e Dritës, këtë herë e fitoi në kampionat me rezultat 2-0. Kryeqytetasit e shënuan golin e parë kundër Dritës në minutën e 18-të, kur krosimin e Krasniqit e shfrytëzoi Leotrim Bekteshi që realizoi për 1-0. Ekipi mysafir nga minuta e 61-të ka luajtur pa një lojtar, pasi u përjashtua nga loja Onoka. Dhjetë minuta më vonë Kastriot Rexha e barazoi rezultatin, por goli u anulua për shkak të pozitës jashtë lojës. Në fund të ndeshjes rezultatin final 2-0 e vulosi zëvendësuesi Tun Bardhoku. Pas kësaj xhiroje, Prishtina ngritët në kuotën e 41 pikëve dhe është në vendin e tretë, Drita pozicionohet një pozitë më lart me 44 pikë. “Personalisht mendoj se kemi bërë një ndeshje të mirë. Mendoj

## KOK-u ndan 22 bursa për 'Shpresa Olimpikë 2021'

**PRISHTINË, 24 SHKURT** - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2021 të ndajë nga buxheti i vet bursa “Shpresa Olimpikë 2021”. Për dallim nga viti 2020, kur u ndan 10 bursa, këtë herë ky numër ka shkuar në 22, ndërsa përfitues do të jenë sportistë të moshës 15 deri në momentin kur kanë mbushur 21 vjeç. 22 sportistët vijnë nga 16 federata të ndryshme olimpikë, përfshirë edhe të gjitha federatat ekipore. Bazuar në të arriturat e tyre gjatë vitit 2020, Bordi Ekzekutiv i KOK-ut ka ndarë bursistët në tri grupe, ndërsa ata do të përfitojnë shumat në vlerë 100 deri në 150



euro në muaj gjatë tërë vitit 2021. Krahas tyre, KOK-u javë më parë ka përzgjedhur edhe 10 bursistë të tjerë “Shpresa Olimpikë 2021”,

të cilët do të përfitojnë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shumën në vlerë 150 euro në muaj.

**Vlera 150 euro në muaj:**

Eda Zegiri (not)  
Vesa Ibrahim (karate)  
Arbër Kullashi (xhudo)  
Bashkim Bajoku (boks)  
Yllka Jashari & Melirona Avdullahi (volejboll) nga 75 euro  
Kiana Kryeziu (skitari)

**125 euro në muaj:**

Albina Deliu (atletikë)  
Fresk Sylhasi (tenis)  
Olt Kondriolli (not)  
Bleoni Bytyqi (mundje)  
Berton Nuha (çiklizëm)  
Kreshnik Mahmuti (pingpong)

**100 euro në muaj:**

Albulena Guri (futboll)  
Asteria Tuhina (basketboll)  
Betim Idrizi (hendboll)  
Arbnor Berisha (shenjëtari sportive)  
Shega Hasani (pingpong)  
Bleor Ivanja (triathlon)  
Auron Sylja (mundje)  
Edonit Telaku (shenjëtari sportive)  
Lirije Peci (triathlon)

## Khaka: Më kritikoni mua, jo familjen

**LONDËR, 24 SHKURT** - Mesfushori shqiptar i skuadrës së Arsenalit, Granit Khaka, ka kërkuar që të kritikohet vetëm ai dhe jo edhe familja e tij. “Jam njeri në fushë. Nuk është gruaja ime, fëmija im ose familja ime. Nëse dëshiron të më kritikosh, më kritiko. Kam dëshirë t'i takoj ata njerëz, të ulem afër tyre dhe t'i pyes: 'Pse jeni duke i shkruar këto gjëra?', ka thënë Khaka. “Nuk i sheh si mbështetës të klubit, për ta mbështetur klubin duhet kur humb, barazon ose fiton. Sigurisht, ti mund të më kritikosh dhe të thuash çfarë dëshiron për futbollin, por jo për personin ose familjen e tij”, ka shtuar Khaka.



## Vëllaznimi triumfon ndaj Prishtinës

**PRISHTINË, 24 SHKURT** - KB Vëllaznimi ka mundur Sigal Prishtinën në kryeqytet me rezultat 74:86 (13:19, 24:24, 21:24, 16:19) në kuadër të javës së 20 në Superligën e Kosovës në Basketboll. Fillimi i ndeshjes ishte i barabartë, por më pas u shkëputën mysafirët në 7:19, derisa çereku i parë përfundoi 13:19.

“Kuqezinjtë” edhe në periodën e dytë kishin epërsi në nëntë pikë, 19:28, por një seri e mirë e vendësve bëri që “bardhekaltrit” të kalojnë në epërsi 30:29. Pas lojës së barabartë, skuadra nga Gjakova ishte më e mirë në fund dhe përfundoi pjesën e parë në të mirë të saj 37:43. Vëllaznimi e nisi pjesën e dytë

shumë më mirë, duke pasur epërsi 13 pikë, 48:61, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 58:67. Në 10 minutat e fundit, pavarësisht prej përpjekjeve të vendësve, Vëllaznimi arriti ta menaxhojë epërsinë, madje edhe ta shtojë dhe në fund triumfoi 74:86. Te Sigal Prishtina u dalluan

Nigel Johnsoni me 20 pikë e tetë asistime dhe Tevin Macku me 25 pikë e gjashtë kërcime, kurse te Vëllaznimi më të dalluarit ishin Emmanuel Emogbo me 36 pikë e 15 kërcime dhe Ty Nichols me 26 pikë e gjashtë asistime. Sigal Prishtina ka gjashtë fitore dhe 14 humbje, kurse Vëllaznimi pesë fitore dhe 15 humbje.

## 'Bild': Kloppi do të jetë pasardhës i Lowit

LIVERPOOL, 24 SHKURT - Jurgen Kloppi në intervistat e dhëna së fundmi ka mohuar kategorikisht një largim të parakohshëm nga stoli i "The Reds", duke nënvizuar se do ta

respektojë kontratën aktuale e cila i skadon në verën e vitit 2024. Megjithatë, gazeta prestigjioze gjermane "Bild" vazhdon të këmbëngulë se Jurgen Kloppi do të jetë

trajneri i ri i Gjermanisë pas përfundimit të Botërorit Katar 2022, duke zëvendësuar në këtë post Joachim Lowin. Kloppi është pjesë e Liverpoolit që prej vitit 2015

dhe në këto pesë vjet e gjysmë me të kuqtë ka arritur ta rikthejë skuadrën te titulli kampion në Premierë Ligë pas 30 vjetësh dhe ka fituar edhe një Ligë të Kampionëve.



## FIBA Evropa lavdëron FBK-në për organizimin e suksesshëm të 'Bubble' në Prishtinë

PRISHTINË, 24 SHKURT - Drejtori ekzekutiv i FIBA Evropës, Kamil Novak, me anë të një letre ka falënderuar Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK) për organizimin e suksesshëm të Fluskës në Prishtinë. "Në emër të FIBA Europe, dëshiroj ta shpreh mirënjohjen time për federatën tuaj dhe Komitetin Organizativ Lokal. Faleminderit përpjekjeve të bëra për ta pritur Kupën Botërore të Basketbollit FIBA 2023 nga 15 deri më 21 shkurt 2021 në Prishtinë. Ne e vlerësojmë angazhimin tuaj për të organizuar me sukses Fluskën, një detyrë jo e lehtë në këtë skenar pandemik Covid-19 me disa kufizime në drejtim të udhëtimit dhe organizimit të ngjarjeve. Ne vlerësojmë mbështetjen dhe angazhimin tuaj për t'i përfshirë autoritetet tuaja shtetërore për t'i marrë lejet e nevojshme dhe/ose përjashtimet për ta lehtësuar hyrjen dhe qëndrimin e lojtarëve në vendin tuaj. Përkundër të gjitha vështirësive, së bashku me ju dhe ekipin tuaj, ne kemi qenë



në gjendje t'i kapërcejmë të gjitha pengesat dhe të përfundojmë garat e planifikuara në një mënyrë të suksesshme. Ne shpresojmë të presim ngjarje të mëtejshme në vendin tuaj", thuhet në letren nga Novak, dërguar FBK-së. Nga 15 deri më 21 shkurt, katër kombëtare, Kosova, Islanda, Sllovakia dhe Luksemburgu, ishin akomoduar në Prishtinë, derisa ndeshjet u zhvilluan më 18 dhe 20 shkurt. Pavarësisht

prej vështirësive dhe gjendjes me Covid-19, FBK-ja ka organizuar në mënyrën më të mirën garën që është zhvilluar në kryeqytetin e Kosovës, duke marrë lëvdata nga FIBA Evropa. FBK-ja më herët ka organizuar Kampionatin Evropian, Divizionin C për meshkuj U18 dhe Evropianin e Divizionit B për femra U20, kurse gjatë kësaj vere do ta organizojë Evropianin e Divizionit C për meshkuj U16.

## Fitojnë Golden State, Clippersat dhe Dallasi

SAN FRANCISCO, 24 SHKURT - Ka përfunduar një tjetër xhiro në NBA, derisa përballjet e zjarra as kësaj radhe nuk munguan. Golden State Warriors ka triumfuar ndaj New York Knicksit me rezultat 114-106, e që nuk ishte aspak e lehtë për të. Fitore në këtë rreth ka regjistruar edhe Los Angeles Clippersi që nuk lejoi befasi nga Washington Wizardsi, pasi e mposhti 135-116. Për ta arritur triumfin e madh, Cleveland Cavaliersi është dashur që të djersitej më shumë ndaj Atlanta Hawksit, pasi fitoi 112-111. Orlando Magicu, në anën tjetër, ka pësuar disfatë ndaj Detroit Pistonsit me shifrat 105-93. Brooklyn Netsi, po ashtu, mori një fitore më komode ndaj Sacramento Kingsit, pasi triumfoi 127-118. Fitore më të ngushtë mori edhe Dallas Mavericksi që luajti ndaj Boston Celticsit me rezultat 110-107. Mund të thuhet se fitore më spektakolare mori



Milwaukee Bucksit që fitoi ndaj Minnesota Timberwolves me shifrat 139-112. Toronto Raptorsit, në anën tjetër, pësoi disfatë nga Philadelphia 76ers

me shifrën 109-102. Fitore në këtë javë në NBA mori edhe Denver Nuggetsit që përballjen me Portland Trail Blazersin me numrat 111-106.

### SHKURT

#### Trajneri Lennon largohet nga Celticu

Neil Lennon ka marrë një vendim të papritur duke u larguar nga drejtimi i Celticit. Në ekipin që ka dominuar prej vitesh kampionatin në Skoci, situata është e trazuar së tepërmi këtë sezon pas paraqitjeve të dobëta dhe diferencës prej 18 pikësh me rivalët e përjetshëm të Glasgowit, çka ka shkaktuar edhe protesta të forta te tifozët. Në një situatë të tillë, trajneri Lennon vendosi të japë dorëheqje me efekt të menjëhershëm, ndërsa drejtimin e skuadrës e merr ndihmësi i tij John Kennedy.

#### Lewandowski: Sërish e synojmë Ligën e Kampionëve

Sulmuesi Bayern Munchen, Robert Lewandowski, ka thënë se skuadra gjermane synon edhe sivjet të triumfojnë në garën e Ligës së Kampionëve. 32-vjeçari arriti në kuotën e 72 golave, në ndeshjen që Bayerni e fitoi në Itali kundër Laizos (1-4). "Jemi kampionët në fuqi, mjafton kjo për ta menduar se jemi skuadra që duhet mundur. Kemi bërë një punë të mirë deri tani dhe shpresoj që të vazhdojmë kështu deri në fund. Fitorja në ndeshjen e parë me Lazio na jep më shumë besim dhe siguri në rrugën tonë. Nuk do të jetë e lehtë, ashtu siç nuk ishte në sezonin e kaluar, por ia dolëm duke luajtur të bashkuar dhe për një qëllim. Këtë sezon kemi një skuadër më të fortë dhe më të pjekur. Pse jo, të mos provojmë sërish për të qenë të parët. Duhet t'i marrim ndeshjet një nga një dhe më pas të shohim se sa larg do të shkojmë", ka thënë Lewandowski.

#### Tri klube italiane e duan Matan

Juan Mata duket se do të largohet nga Manchester Unitedi në fund të këtij edicioni. Mesfushori spanjoll nuk është në planet e Ole Gunnar Solskjaer dhe po kërkon aventurë të re. Sipas asaj që raporton "The Sun", Mata mund të largohet nga Unitedi, por nuk do të ulë nivelin e lartë të klubeve. Mediumi anglez bën të ditur se Juventus, Roma dhe Interi janë futur në garë për t'i marrë shërbimet e tij. Lojtari 32-vjeçar është i gatshëm që të testojë veten në Serinë A dhe do të ketë mundësi që të fitojë edhe trofe. Antonio Conte thuhet se e pëlqen lojën e spanjollit qysh nga koha kur ishte në Ligën Premierë si trajner i Chelsea. Një simpati për të ka edhe Andrea Pirlo që, po ashtu, e preferon transferimin e tij në "Allianz Stadium".

#### Ruiz: Fury do ta mposhtë Joshuan

Andy Ruiz Jr, ish-kampion i botës në peshën e rëndë, mendon se Tyson Fury do ta fitojë duelin ndaj Anthony Joshuas, një sfidë që pritet të zhvillohet këtë verë dhe do t'i unifikojë titujt kampionë bote të këtij divizioni. Sipas Ruizit, i cili i ka 33 fitore, 2 humbje në karrierë, Joshua nuk është përballur kurrë me një boksier me aftësitë e Fury dhe stili i tij i boksimit do t'i shkaktojë probleme në ring. "Unë mendoj se do të jetë një sfidë interesante. Unë jam përballur dy herë me Joshuan (1 fitore, 1 humbje), por asnjëherë me Fury. Tyson Fury ka një stil të çuditshëm boksimit. Është i gjatë dhe bokson lart. Unë e shoh atë fitues në këtë sfidë ndaj Joshuas", ka thënë Ruiz. "Joshua nuk më pëlqeu shumë në duelin ndaj Pulevit, ndaj mendoj se Fury fiton. Gjithsesi, në sport asnjëherë nuk i dihet. Gjithçka do të varet edhe nga forma e Furyt. Fakt është që Joshua nuk është përballur me një boksier si Fury, që lëviz shumë në ring dhe bokson fort", ka shtuar ai.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzgjenezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**



ISBN 978-9951-780-37-7

9 789951 780377

ÇMIMI: 5.99 €



AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.



ISBN 978-9951-780-10-0

9 789951 780100

4<sup>99</sup> €

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opština Dragash/Drags Municipality  
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/90  
Më: 23/02/2021  
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

#### KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020/2021.

#### SHFMU "Fetah Sylejmani" Dragash

1. Një mësimdhënës për mësim klasor – Shajne (deri sa punëtorja të kthehet nga pezullimi i dakorduar, munges nga puna pa pagesë)
2. Një mësimdhënës për gjuhë angleze ( 18 orë deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

#### SHFMU " Sezai Surroi"- Bellobrad

1. Një mësimdhënës për mësim klasor – Bellobrad (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

#### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.), Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës), Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj, Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar, Certifikata që nuk jeni nën hetime, Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë:23.02.2021  
Dragash

Drejtori i DKA-së  
MSc. Vloran Cenaj

#### NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se “DJ LAZZY” SH.P.K. pronar Ilaz Shkodra, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810114372 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

#### OBAVESTENJE

Obavestavjanje se svi klienti da drustvo sa “DJ LAZZY” D.O.O. Ilaz Shkodra donelo odluku o prestani rada sa nr. 810114372, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

#### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “DJ LAZZY” L.L.C. Ilaz Shkodra, has come to the decision to quit its nr. 810114372, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

#### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Mustaf Shala shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Emin Duraku " Prizren.
- ▶ Fahreta Elezi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Ekrem Rexha Drini " Prizren.
- ▶ Elvira Redza shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Esat Musaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.
- ▶ Ali Gjakolaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.
- ▶ Ajdin Qovanaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Heronjet e Lumes " Vermic.
- ▶ Bedri Qovanaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Heronjet e Lumes " Vermic.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoh një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

